

**L I G J**  
**Nr.7813 datë 14.4.1994**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7697, DATË 7.4.1993 “PËR KUNDËRVAJTJET  
ADMINISTRATIVE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, neni 20 ndryshohet si vijon:

“Gjobat dhe të ardhurat e vjela sipas neneve 6 e 7 të këtij ligji kalojnë në buxhetin e shtetit, përveç rasteve kur rrjedhin nga:

a) kundërvajtje të konstatuara nga organet e shërbimit të policisë rrugore, nga të cilat 70 për qind kalojnë në favor të Ministrisë së Rendit Publik për nevoja të shërbimit rrugor dhe 30 për qind në favor të buxhetit të shtetit.

b) kundërvajtje të miratuara nga organet kolegjiale të pushtetit lokal, nga të cilat 85 për qind kalojnë në favor të buxhetit lokal dhe 15 për qind në favor të buxhetit të shtetit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.827, datë 20.4.1994 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.**